



Pranuar / Dërguar Prilaps / Prototo Received / Delivery	09.10.2018	viti Eed year	
Organ / Bësi Org./Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5870/2018		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.523/2018

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga:** Eshref Shabani-kryetar, Shkëmb Manaj dhe Lulzim Aliaj-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.523/2018 të datës 15.08.2018 e parashtruar nga ankuesi Fitim Veliqi, kundër vendimit me numër 01-120-38181 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës/kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.10.2018, mori këtë:

### V E N D I M

**I. HEDHET poshtë si e palejuar** ankesa me numër të protokollit 4687/2018 e datës 15.08.2018 me numër të ankesës A.nr.523/2018 e parashtruar nga ankuesi Fitim Veliqi.

**II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 01-120-38181 i datës 17.07.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit.

### A r s y e t i m

Ankuesi Fitim Veliqi, me datë 18.09.2015 ka nënshkruar akt emërimit me Komunën e Drenasit në vendin e punës “Inspektor i Ndërtimit” në Drejtorinë e Inspektionit, me nivel profesional të gradës 9/2. Me datë 16.09.2016 ankuesi nënshkruan akt emërimit me numër 01-112-54804 me të cilën ankuesit i caktohet niveli profesional grada 8/3.

Ankuesi Fitim Veliqi, me datë 04.07.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 01-120-38181 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit me pretendim ankimor për përmisimin e koeficienti aktual të pagës nga gjashtë (6) në koeficient shtatë (7) në përputhje me akt emërimit e datës 16.09.2016, aprovimin e kompensimit të dëmit në vlerë bruto prej 2.145.0 Euro për mos pagesën e një koeficienti në kohëzgjatje prej 33 muajsh, njohjen e përvojës së punës tre vjeçare të kaluar jashtë shërbimit civil si dhe aprovimin e dëmit në vlerë prej 201.96 euro të shkaktuara të mos pagesës së përvojës së punës tre vjeçare të kaluar jashtë shërbimit civil.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit me datë 17.07.2018 merr vendimin me numër 01-120-38181 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit Fitim Veliqi.

Ankuesi Fitim Veliqi, i pa kënaqur me vendimin e datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit, me datë 15.08.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 4687/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit me datë 31.08.2018 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës 1/18.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 15.08.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 25.09.2015; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 15.09.2016; Akt emërimi i datës 16.09.2016; Vendimi i Ministrisë të Administratës Publike i datës 12/2016 i datës 05.02.2016; lista e pagave; Vendimi i datës 17.07.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit; Ankesa e ankuesit e datës 04.07.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit; Vlerësimi i punës për vitin 2017 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e paraqitura nga palët dhe konstatoi se ankesa e ankuesit Fitim Veliqi, ***është e palejuar, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar, se ankuesi Fitim Veliqi, me datë 16.09.2016 ka nënshkruar akt emërimin me nivelin profesional të gradës 8/3, dhe organi i punësimit ka qenë i obliguar që ta dërgoj ndryshimin e koeficientit të ankuesit në ministrinë përgjegjëse dhe ankuesit kur i ka dal paga në xhirollogarin e tij në muajin nëntor të vitit 2016 me koeficient gjashtë (6) ka qenë në dijeni se nuk është paguar në pajtim me akt emërimin e datës 16.09.2016 me numër 01-112-54804, ndërsa ankuesi me datë 04.07.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 01-120-38181 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit për mos kompensim sipas pretendimeve ankimore të ankuesit në ankesën e datës 04.07.2018 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit, andaj ankuesi e ka parashtruar ankesë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet që: ***“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”.***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit me rastin e marrjes së vendimit me numër 01-120-38181 të datës 17.07.2018 ka vepruar në kundërshtim me rregulloren Nr.05/2011 për Procedurën e Zgjidhjen se Kontesteve dhe të Ankesave sepse nuk ka arritur që të konstatoj afatshmërinë e ankesës së ankuesit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
lënda me numër 523/2018**

**Eshref SHABANI**

  
Kryetar i Kolegjit



**Valentina KAÇANDOLLI BEKTESHI**

  
Procesmbajtëse

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit Fitim Veliqi;
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

